

**Roli i shoqërisë civile në programimin e ndihmës financiare të BE-së për Kosovën:  
Theksi mbi Dokumentin Strategjik të Vendit (CSP) brenda periudhës IPA II  
2014 - 2020**



*financed by*

**Austrian**  
**Development Cooperation**

**Komentari III**

***“Roli i shoqërisë civile në programimin e ndihmës financiare të BE-së për Kosovën:  
Theksi mbi Dokumentin Strategjik të Vendit (CSP) brenda periudhës IPA II  
2014 - 2020”***

**Nëntor 2013  
Prishtinë**

**Roli i shoqërisë civile në programimin e ndihmës financiare të BE-së për Kosovën:  
Theksi mbi Dokumentin Strategjik të Vendit (CSP) brenda periudhës IPA II  
2014 - 2020**

## **I. Hyrje**

Ndihma teknike dhe financiare për vendet e zgjerimit të BE-së, përfshirë Kosovën, është aktualisht duke u dhënë përmes **Instrumentit për Ndihmë Para Asocimit (IPA) 2007 - 2013**<sup>1</sup>. Ky instrument do të mbarojë në fund të vitit 2013. Në drejtimin e zgjerimeve të reja, BE-ja do të vazhdojë t'u ofrojë vendeve candidate dhe atyre potenciale ndihmë teknike dhe financiare për t'i ndihmuar reformat e tyre në transicion dhe në zhvillim të qëndrueshëm. Si rezultat i kësaj Komisioni Europian është në procesin e propozimit të një rregulloreje për miratim nga Këshilli dhe Parlamenti, për fazën e dytë të **Instrumentit për Ndihmë Para Asocimit për vitet 2014 – 2020**.

Në komunikatën e qershorit 2011 *'Buxheti për Europë 2014 - 2020'*, Komisioni Europian ka propozuar të ndajë një shumë prej **14 miliardë eurosh** për Instrumentin e ri të Ndihmës Para Asocimit për një periudhë 7-vjeçare.<sup>2</sup>

**Instrumenti i ri për Ndihmë Para Asocimit - IPA II** do të vazhdojë të fokusohet tek zbatimi i politikës së zgjerimit, e cila është një prej prioriteteve themelore të Veprimit të Jashtëm të BE-së (EU External Action), duke ndihmuar kështu në promovim të stabilitetit, sigurisë dhe prosperitetit në Europë. Në këtë kuptim instrumenti i ri do të vazhdojë të zbatojë synimin e përgjithshëm të politikave në mbështetje të Kosovës në përgatitjet e saj për anëtarësim në BE, si dhe për përafrim progresiv të institucioneve e ekonomisë së saj me standardet dhe politikat e Bashkimit Europian, sipas nevojave të saj specifike dhe të përshtatur me procesin e integritimeve të saj. Duke vepruar kështu, pritet të përforcohet përputhshmëria mes ndihmës financiare dhe përparimit të përgjithshëm të arritur në implementim të strategjisë së paraasocimit.<sup>3</sup>

Synimet e ndihmës së tillë do të përkufizohen në **Dokumentet indikative Strategjike të Vendeve (CSP)** të hartuara nga Komisioni për një kohëzgjatje prej 7 vjetësh, në partneritet me vendin përfitues, në këtë rast me Kosovën, në bazë të nevojave të saj specifike dhe agjendës së integritimeve. Dokumenti strategjik identifikon fushat e politikave për ndarje të ndihmës, si dhe projekton ndarjet indikative të fondeve sipas fushave të politikave të ndara në vite. Në këtë aspekt do të lejohet edhe fleksibilitet i mjaftueshëm për të mundësuar plotësimin e nevojave të reja dhe për të stimuluar përmirësimin e performancës.<sup>4</sup> Dokumenti strategjik duhet të sigurojë koherencë dhe konsistencë me përpjekjet e vendeve përfituese, të reflektuara në buxhetet vendore, si dhe duhet të marrë parasysh përkrahjen e ofruar nga donatorët e tjerë. Për të marrë parasysh zhvillimet e brendshme dhe të jashtme, duhet reviduar sipas nevojës **dokumenti strategjik indikativ shumëvjeçar**.<sup>5</sup>

<sup>1</sup> Rregullorja e Këshillit 1085/2006, e datës 17 korrik 2006

<sup>2</sup> Për më shumë, vizito [http://europa.eu/legislation\\_summaries/budget/bu0001\\_en.htm](http://europa.eu/legislation_summaries/budget/bu0001_en.htm)

<sup>3</sup> Dokumenti Strategjik për Kosovën (versioni i shtatorit 2013) 2014 – 2020

<sup>4</sup> Propozimi për Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi Instrumentin e Ndihmës Para Asocimit (IPA II). Bruksel 7.12.2011

<sup>5</sup> Struktura e Dokumenteve Strategjike për Vendet të mbuluara nga IPA II

**Roli i shoqërisë civile në programimin e ndihmës financiare të BE-së për Kosovën:  
Theksi mbi Dokumentin Strategjik të Vendit (CSP) brenda periudhës IPA II  
2014 - 2020**

**Projektdokumenti strategjik vendor për Kosovën (CSP)** përgatitet nga Komisioni European, me angazhimin e institucioneve të Kosovës, përmes Ministrisë së Integritimit European. Përveç kësaj, strategjia është konsultuar, si dhe janë kërkuar kontributet me shkrim nga organizatat e shoqërisë civile. Strategjia mbulon periudhën 2014 – 2020, derisa një rishikim afatmesëm parashikohet të bëhet më 2017. Strategjia identifikon sektorët kryesorë të **ndihmës nga IPA**, ku specifikohen **synimet specifike për secilin sektor** që duhet arritur deri më 2020, **aktivitetet e propozuara dhe indikatorët** për matjen e progresit. Përzgjedhja paraprake e sektorëve për IPA II në Kosovë përfshin: sundimin e ligjit dhe drejtësinë, punët e brendshme, bujqësinë, sigurinë e ushqimit, energjinë, zhvillimin socio-ekonomik, si dhe ndërtimin e institucioneve.<sup>6</sup> **Buxheti për IPA II** për Kosovën vlerësohet në shumën prej 70 milionësh në vit, pra rreth 500 milionë euro për periudhën 7-vjeçare. Aktualisht kjo strategji i është nënshtruar një procesi të konsultimeve të brendshme mes shteteve anëtare të BE-së, si dhe pritet të miratohet nga KE-ja në tremujorin e dytë apo të tretë të vitit 2014.

Ndihma e para anëtarësimit për Kosovën në të ardhmen duhet të jetë edhe më strategjike, më efikase dhe më mirë e shënjestruar sesa që ka qenë deri tash, me qëllim të arritjes së rezultateve më të qëndrueshme që reflektojnë pronësinë, partneritetin dhe stimujt e prioritetet lokale. Një shenjë pozitive është që IPA II do të veprojë në mënyrë më fleksibile, si dhe do të lëvrojë më shumë fonde nga donatorët e tjerë ose nga sektori privat, duke përdorur instrumente inovative financuese dhe duke synuar thjeshtim dhe zvogëlim të barrës administrative që përcjell menaxhimin e ndihmës financiare.

Kështu angazhimi i shoqërisë civile në dizajnimin e ndihmës financiare të BE-së për Kosovën është me rëndësi të madhe. Së pari, organizatat e shoqërisë civile janë në pozitë mjaft të mirë të caktojnë prioritetet e ndihmës teknike dhe financiare si dhe, së dyti, janë më të njohura me nevojat lokale dhe mund të përafrojnë projektet me përfituesit e drejtpërdrejtë apo grupet e shënjestruara. Për më tepër, shoqëria civile është në gjendje të identifikojnë kapacitetet dhe stimujt lokalë për partneritetet më të qëndrueshme. Kështu, angazhimi i tyre i hershëm si dhe kontributi në programimin dhe formësimin e ndihmës së BE-së është thelbësor.

Takimet sektorale dhe plenare të dialogut të PSA-së me shoqërinë civile sigurojnë një strukturë të mirë për programimin e ndihmës financiare. Megjithatë, në bazë të natyrës së dokumenteve të programimit financiar,<sup>7</sup> i cili përfshin çështje tejet teknike dhe komplekse, çelësi i kontributit të suksesshëm është të qenit i fokusuar në një sektor, marrja e një qëndrimi proaktiv, si dhe dërgimi i kontributeve me shkrim. Kështu, KCSF-ja dëshiron të ndajë mendimin dhe komentet e veta për procesin e projektimit të ndihmës financiare të BE-së për Kosovën. Këto vërejtje janë dërguar edhe si kontribut me shkrim nga KCSF për **Dokumentin Strategjik të Vendit për Kosovën (CSP) 2014 – 2020**.

<sup>6</sup> Dokumenti Strategjik për Kosovën (versioni i shtatorit 2013) 2014 – 2020

<sup>7</sup> Këto përfshijnë Dokumentet Strategjike për Vendet, Programimin Vjetor të IPA-s, sektorët e projekteve, TeR

**Roli i shoqërisë civile në programimin e ndihmës financiare të BE-së për Kosovën:  
Theksi mbi Dokumentin Strategjik të Vendit (CSP) brenda periudhës IPA II  
2014 - 2020**

**II. Komentet e KCSF-së për Dokumentin Strategjik të Vendit (CSP) IPA II për Kosovën  
2014 – 2020**

**Vërejtjet e përgjithshme:**

- Ne mirëpresim qëllimin e mirë të KE-së për një **mënyrë më përfshirëse** të hartimit të përkrahjes nga IPA 2014 - 2020 në krahasim me ciklin IPA 2007 - 2013;
- Ne mirëpresim të rejat e sjella nga IPA II në përkrahjen e zbatimit të nevojave të domosdoshme, por edhe ato të zhvillimit social dhe ekonomik përmes pesë (5) fushave tematike të politikave, e veçanërisht që ndihma nga IPA-ja do të përdoret për të kontribuar në implementimin e **politikave vendore të reformës së vetë përfituesve** (pra Kosovës).
- Po ashtu mirëpresim ndryshimin e qasjes së ndihmës financiare të BE-së, si dhe futjen e **elementit të performancës**, i cili shpresojmë se do të përmirësojë absorbimin dhe cilësinë e projekteve në përputhje me vëmendjen e rritur të qeverisë ndaj efikasitetit.
- Deri tani KCSF-ja ka marrë pjesë aktive në procesin e **programimit dhe zbatimit** të programeve vjetore të IPA-s brenda ciklit të mëparshëm. Andaj, ne çojmë mundësinë e angazhimit në konsultime të strukturuar në rastin kur zhvillohen plane të mëtutjeshme vjetore dhe afatmesme.

Konkretisht KCSF-ja ka kërkuar vëmendjen e KE-së ndaj:

- CSP-ja dhe e gjithë përkrahja nga IPA II duhet të jetë plotësisht **e përputhur me politikat vendore reformuese, si dhe me strategjitë ekzistuese apo me ato të ardhme**. Një vështrim më i afërt do t'u hidhet strategjive të vjetruara që janë përmendur në CSP, si dhe në vend të tyre të kihen parasysh strategjitë e rishikuara apo ato të ardhme. Në këtë kuptim ne bëjmë thirrje që CSP-ja, si dhe ndihma financiare të ndërlihet ngushtë me **Strategjinë Shtetërore për Integritet Europian 2014 – 2020**.
- Përkrahja financiare duhet kushtëzuar me **indikatore të arritjes**, si dhe të monitorohet/ndërlihet afërsisht me vlerësimet vjetore të Raportit të Progresit të KE-së. Në këtë drejtim do të krijohen indikatorët **SMART** (Specifikë, të Matshëm, të Arritshëm, Realë dhe Kohorë (Timely)) për llojet e planifikuara të veprimeve, për të mundësuar vlerësimet vjetore, e veçanërisht ato afatmesme, të ndihmës, e sipas nevojës, edhe për të riformësuar përkrahjen.
- Në draftin aktual të CSP-së (qershor 2013), Kosova do të përfitojë vetëm nga tri (3) **fusha politike e sektorë ndihme për periudhën 2014-2020**, për: 1) procesin e transicionit dhe ndërtimin e institucioneve (TAIB), 2) zhvillimin rajonal (RD), 3)

**Roli i shoqërisë civile në programimin e ndihmës financiare të BE-së për Kosovën:  
Theksi mbi Dokumentin Strategjik të Vëndit (CSP) brenda periudhës IPA II  
2014 - 2020**

bujqësinë dhe zhvillimin rural. Kosova duhet të ketë mundësi të përfitojë edhe nga dy fushat e tjera politike të IPA-s II, që janë; 4) punësimi, politikat sociale dhe zhvillimi i burimeve njerëzore, si dhe 5) bashkëpunimi rajonal dhe territorial, ashtu që të përgatitet për procesin e asociimit, të ndërtojë kapacitetet, të diversifikojë financimin dhe të plotësojë mbështetjen. Në këtë linjë cili do të jetë fati i projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar?

- Duhet **bërë një ndarje e qartë e financimit (%)** sipas fushave të politikave dhe sektorëve të përkrahur, për të mundësuar planifikimin e mirëfilltë dhe ndërlidhjen me reformat vendore, në veçanti me KASH-in dhe planifikimin buxhetor vjetor të Kosovës.
- Derisa përkrahja i duhet ofruar OShC-ve përmes CSF-së brenda programit IPA II, duhet lënë edhe hapësirë për përfshirje horizontale të OShC-ve në CSP. Mund të sigurohet një qasje e përfshirjes së OShC-ve në programim, zbatimin e një procesi më përfshirës gjatë implementimit të fushave tematike, ku ekzistojnë ekspertiza dhe interesimi, si sundimi i ligjit, antikorrupsioni, punët e brendshme, të drejtat e njeriut, mbrojtja e pakicave, zhvillimi ekonomik dhe social, energjia, bujqësia, etj.
- Paralelisht me përfitimin nga përkrahja e BE-së, roli i shoqërisë civile në CSP duhet të përfshijë edhe **monitorimin e** përkrahjes nga BE-ja dhe efikasitetin e saj.
- **Ndryshimet pozitive** në përkrahjen e zhvillimit të shoqërisë civile në vendet në asociim, brenda IPA CSF 2007-2013, në veçanti programimi më fleksibil, dispozicioni më afatgjatë programor, qasja më fleksibile, si dhe arritja tek organizatat bazë, përmes rigrantimeve, duhet të vazhdojë edhe tek IPA II 2014 – 2020, si dhe të bazohet tek mësimet që janë nxjerrë nga cikli i mëhershëm;

**Roli i shoqërisë civile në programimin e ndihmës financiare të BE-së për Kosovën:  
Theksi mbi Dokumentin Strategjik të Vendit (CSP) brenda periudhës IPA II  
2014 - 2020**

**III. Komentet përfundimtare**

Me qëllim të inkurajimit të OJQ-ve kosovare që të dërgojnë komentet me shkrim për programimin e ndihmës së BE-së, KCSF-ja ka përgatitur këtë koment, duke ndarë vërejtjet e veta të përgjithshme dhe komentet specifike për CSP-në e Kosovës 2014 - 2020. Në këtë fazë të programimit, kur CSP-ja është në përfundim e sipër, këto komente mund të përdoren si mësim nga partnerët e shoqërisë civile. Duke i bërë publike dhe në dispozicion për OJQ-të e tjera, komentet e shkruara nga KCSF-ja ofrohen për t'u përdorur si instrument për promovimin dhe avokimin e kontributeve të shkruara nga OShC-të, sapo që fazat e ardhshme të programimit të ndihmës financiare të BE-së të fillojnë.

Këto komente dhe kontributet me shkrim për KE-në janë rezultat i përvojës së KCSF-së në menaxhim dhe implementim të fondeve të BE-së, të dhënave të ndryshme të brendshme, të takimeve me partnerë e palë të përfshira lokale, të vrojttimeve e prezantimeve në konferenca të ndryshme, të njohurive të akumuluar përmes përfituesve të projekteve e granteve, si dhe rrjeteve të mirëfillta rajonale e Europiane.

Komentet e shkruara nga KCSF-ja janë mes kontributeve të pakta të OJQ-ve kosovare në programimin e fazës së ardhshme të ndihmës financiare të BE-së. KCSF-ja synon të përdorë këtë model për të inkurajuar organizatat e shoqërisë civile që të kontribuojnë dhe të marrin pjesë në programimin e ndihmës financiare të BE-së.

Sfida e radhës është të qenit proaktiv dhe kontribuimi në caktimin e prioriteteve, si dhe përafrimi i projekteve përkatëse brenda ciklit programues vjetor të IPA-s. Pasi grupet e projekteve me bazë sektorale të fillojnë së hartuari, roli i veçantë i OJQ-ve kosovare bie tek dizajnimi i synimeve, rezultateve, ndikimit e përfituesve të duhur të projekteve. Përmes këtij procesi organizatat e shoqërisë civile mund të luajnë një rol jetik në mundësimin e ndihmës financiare në dispozicion të Kosovës, që është relevante, efektive, e dobishme dhe në shërbim të nevojave e prioriteteve lokale.